



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-155
Prishtinë, 27 shkurt 2014

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 27 E 28 SHKURT DHE MË 13 MARS 2014**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së parë plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Bekim Haxhiu, Vjollca Krasniqi, Afrim Kasolli, Ardian Gjini, Jeton Svirca, Berat Buzhala dhe Visar Ymeri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se çfarë trajnimesh ka mundësuar Ministria që ai drejton për prokurorët dhe gjyqtarët lidhur me fenomenin e gjuhës së urrejtjes e cila sanksionohet me nenin 147 të Kodit Penal. Zv/kryeministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputeti Agim Kuleta parashtoi pyetje për ministrin Dardan Gashi në lidhje me moszbatimin e vendimit lidhur me themelimin e Drejtorisë për Administrimin e Monumentit të Natyrës me rëndësi të veçantë "Shpella e Gadimes".

Ministri Dardan Gashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me rritjen e pagesës për viktimat civile të luftës.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë, mirëpo me pajtimin e deputetes Teuta Haxhiu, në këtë pyetje u përgjigj zv/kryeministri Hajredin Kuçi.

Deputeti Ramiz Lladrovci parashtroi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se a janë shqyrtuar nga Prokuroria dhe gjyqësori faktet e paraqitura në debatin parlamentar lidhur me rastin “Kiçina” dhe cilët janë hapat e deritashëm në këtë drejtim

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Ramiz Lladrovci.

Deputeti Agim Kuleta parashtroi pyetje për ministrin Fadil Ismajli në lidhje me atë se kush do të aplikojë për kodin telefonik i cili do të ndahet për Kosovën nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit.

Ministri Dardan Gashi nuk ishte i pranishëm në sallë, mirëpo, në këtë pyetje u përgjigj zv/kryeministrja Edita Tahiri e cila tha se këtë e bën në marrëveshje me ministrin Fadil Ismajli.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me nivelin e buxhetit për furnizim me ilaçe dhe medikamente të tjera të nevojshme në QKUK për vitin 2014 dhe çfarë përmirësimi ka pasur në krahasim me vitin 2013.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Nazane Breca parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me fazat e zbatimit të një pilot-projekti në bashkëpunim me Qeverinë e Luksemburgut, në fushën e shëndetësisë.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputetja Nazane Breca parashtroi pyetje për ministrin Dardan Gashi në lidhje me realizimin e vendimit lidhur me mos hedhjen e mbeturinave të termocentralit “B”, në afërsi të fshatrave Dardhishtë dhe Shkabaj.

Ministri Dardan Gashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KI 08/09 të datës 17 dhjetor 2010.

Kryeministrin Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë, mirëpo në këtë pyetje u përgjigj zv/kryeministri Hajredin Kuçi.

Deputeti Faton Topalli parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se është në dijeni ministri Agani lidhur me siç tha ai një aferë detyrimi ndaj një donatori të huaj nga Adem Ademi, i cili udhëheq organizatën “Gjysmëhëna e Kuqe” dhe njëherësh është, siç tha ai, zyrtar i Partisë së Drejtësisë.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Faton Topalli.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me ngritjen e ndonjë hetimi lidhur me proceduarat që kanë të bëjnë me faljen që u bëri Presidentja

e Kosovës, dy personave me rastin e Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, që ishin duke e vuajtur dënimin në burgjet e Kosovës.

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Albulena Haxhiu.

Deputetja Kymete Bytyçi parashtroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me zvarritjen e procedurave për dhënien e aktit për themelimin e Shkollës Profesionale në Shirokë.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Kymete Bytyçi.

* * *

Në vazhdim lidhur me rendin e ditës, për fjalë u paraqitën deputetët Arsim Bajrami dhe Bekim Haxhiu.

Arsim Bajrami, në emër të GP të PDK-së, propozoi që nga rendi i ditës së punimeve të mbledhjes së sotme, të hiqet pika – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe ky projektligj t'i kthehet Qeverisë për ripunim.

Fjala e plotë e deputetit Arsim Bajrami është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me propozimin e deputetit Arsim Bajrami, kryesuesi kërkoi deklaratimet e grupeve parlamentare.

Për propozimin e lartpërmendur, u deklaruan deputetët: Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" dhe Myzeje Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi hodhi në votim propozimin e paraqitur nga deputeti Arsim Bajrami.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 69,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryetari më pas konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Projektligji nr. 04/L-255 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i kthehet për ripunim Qeverisë së Republikës së Kosovës.

* * *

Bekim Haxhiu propozoi që në rendin e ditës së punimeve të mbledhjes së sotme, të radhitet pika – Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 04/L-261 për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke bërë shmangie konform nenit përkatës të Rregullores së Kuvendit.

Fjala e plotë e deputetit Bekim Haxhiu është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me propozimin e deputetit Bekim Haxhiu, kryesuesi kërkoi deklaratimet e grupeve parlamentare.

Për propozimin e lartpërmendur, u deklaruan deputetët: Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Rexhep Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Fikrim Damka - në emër të Grupit Parlamentar "6+" diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi hodhi në votim propozimin e dalë nga qëndrimet e grupeve parlamentare lidhur me këtë çështje, që Projektligji nr. 04/L-261 për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të procedohet në seancë plenare për shqyrtim të parë, sipas Rregullores së Kuvendit.

Kuvendi nëpërmjet një votimi formal u pajtua me propozimin e lartpërmendur.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin që Projektligji nr. 04/L-261 për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të procedohet në seancë plenare për shqyrtim të parë, sipas Rregullores së Kuvendit.

* * *

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua për Projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dh Qeverisë së Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit për vitin 2014,
6. Shqyrtimi i propozim-programit të Punës së Kuvendit për vitin 2014,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kimikate,
9. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë në shkollat e Republikës së Kosovë,
10. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë,
11. Debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të IGK "Ballkan" në Suharekë,
12. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar.

* * *

3. Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme

Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 6 dhe 13 shkurt 2014, pa asnjë vërejtje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua për Projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dh Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua për Projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dh Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Zv/kryeministrja Edita Tahiri, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ratifikimi i kësaj Marrëveshje do të rezultonte me financimin e pjesshëm të ndërtimit të rrugës ekzistuese Milloshevë-Mitrovicë e gjatë 26. 7 km, e cila do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe gjenerimin e punësimit në rajonin e Mitrovicës dhe Prishtinës.

Në vazhdim, ajo foli për strukturën dhe përmbajtjen në tërësi të Projektligjit dhe ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për hua për Projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë, ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Diskutimi i zv/kryeministres Edita Tahiri është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Projektligjit për hua për Projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë, ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji e paraqiti deputeti Naser Osmani.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Xhafer Tahiri - në emër të GP të LDK-së, Xhevdet Neziraj - në emër të GP të AAK-së dhe Myzejene Selmani - në emër të GP të KKR-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi tha se ky projektligj në bazë të Rregullores së Kuvendit, është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Projektligjit për hua për Projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 80,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Ligji nr.04/L-256 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua për Projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Ligji i dërgohet për shpallje Presidentes së Republikës së Kosovës.

5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitin 2014

Kryesuesi i njoftoi deputetët me Planin e Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitin 2014.

Ai hapi debatin për shqyrtimin e Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitin 2014.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Vjosa Osmani - në emër të Komisionit për Integritet Evropian dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së, Shqip Muja - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Glauk Konjufca - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe deputetët: Halit Krasniqi, Alma Lama, Jakup Krasniqi dhe Skender Hyseni, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Planin e Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitin 2014.

5. Shqyrtimi i propozim-programit të Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2014

Kryetari ftoi nënkryetarin e Kuvendit Xhavit Haliti që para deputetëve të paraqesë Propozim-programin e Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2014.

Xhavit Haliti tha se propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2014 paraqet dokument bazë të Kuvendit për aktivitetin e organit ligjvënës të Republikës së Kosovës. Ky program, tha ai është hartuar duke u bazuar në këto dokumente:

- Dokumenti i Qeverisë për Strategjinë Legjislative për vitin 2014,
- Planet e punës së komisioneve parlamentare për vitin 2014,
- Plani i Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në vazhdim ai u fokusua në përmbajtjen e këtij propozim-programi dhe ftoi deputetët që ta miratojnë atë.

Diskutimi i z. Xhavit Haliti është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2014.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Vjosa Osmani - në emër të Komisionit për Integritet Evropian, Elmi Reçica - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Armend Zemaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Gashi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ahmet Isufi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Suzan Novoberdaliu - në emër të Koalicionit Kosova e Re, si dhe deputetët; Arsim Bajrami, Rexhep Selimi, Ardian Gjini, Bekim Haxhiu, Xhevdet Neziraj, Burim Ramadani, Myzejene Selmani, Vjosa Osmani dhe Ahmet Isufi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Propozim-programin e punës së Kuvendit për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 62,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi programin e punës së Kuvendit për vitin 2014.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Deputeti, Ahmet Isufi, në emër të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, paraqiti para deputetëve Raportin me rekomandime.

Kryesuesi më pas hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63 ,
Kundër----- 0 ,
Abstenime----- 0 .

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kimikate

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për kimikate.

Deputeti Daut Haradinaj, në emër të Komisionit Funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, paraqiti para deputetëve Raportin me rekomandime.

Kryetari më pas hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-197 për kimikate.

9. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë në shkollat e Republikës së Kosovë

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se deputetët Ganimete Musliu dhe Jeton Svirca, të mbështetur nga grupi i deputetëve nënshkrues, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë në shkollat e Republikës së Kosovë.

Në vazhdim, kryetari e ftoi deputeten Ganimete Musliu, që në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Ganimete Musliu tha se duke u bazuar në raportet e fundit rreth gjendjes së sigurisë në shkollat e Kosovës, ku dhuna në shkolla ka filluar të bëhet si fenomen shoqëror shqetësues për qytetarë dhe institucionet tona, konsiderojmë të rëndësishme së veçantë që Kuvendi i Republikës së Kosovës të diskutojë në këtë seancë plenare për gjendjen e sigurisë në shkollat e Kosovës.

Jemi dëshmitarë për rastet e dhunës që po ndodhin viteve të fundit në ambientet shkollore, ku statistikat tregojnë që vetëm në vitin 2013 kemi gjithsej 315 raste të dhunës, qoftë në ambiente shkollore, qoftë në afërsi të tyre. Edhe pse në raport me vitin 2012, kjo shifër ka shënuar rënie, shqetësues mbetet fakti që jemi në fillim të vitit 2014 dhe për dy muaj kemi 3 vrasje, gjë që

tregon që gjendja e sigurisë në shkolla është alarmante dhe do trajtim urgjent nga institucionet e vendit.

Rastet e dhunës që paraqiten në shkollat e Kosovës janë në forma të ndryshme, si fyerje, rrahje, ngacmim gjinor, trajtim jo human, deri tek rastet më ekstreme që kanë përfunduar me epilog fatal, vrasjet me armë të ftohta dhe armë zjarri.

Duke mos dashur që ta drejtojmë gishtin nga askujt, por së bashku të debatojmë dhe të kontribuojmë që të krijojmë një ambient të sigurt në shkollat e Kosovës, në vazhdim ajo i përmendi vetëm disa nga rastet e dhunës më specifike që janë evidentuar në shkollat e Republikës së Kosovës, në vitet paraprake.

Ndërsa, më pas foli për rastet e ndodhura në fillim të këtij viti, ku më 8 janar 2014, në oborrin e shkollës “Emin Duraku” është vrarë një 14-vjeçar me armë zjarri dhe një tjetër është plagosur.

Më 28 janar 2014 në shkollën e mesme teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë, nga lëndimet e marra nga sulmi me thikë në ambientet e shkollës, humb jetën një nxënës i po kësaj shkolle. Po ashtu edhe një rast tjetër ka ndodhur në Pejë, më 6 shkurt të këtij viti, ku nga lëndimet me thikë humb jetën edhe një i ri i Kosovës. Në shkollën e Gjellbër në Prishtinë para pak ditësh, po ashtu, një nxënës 11-vjeçar është therur me thikë nga kolegu i tij. Deputetja Musliu më tej foli edhe për bashkëpunimin në rritje ndërmjet shkollave dhe Policisë së Kosovës.

Në fund ajo paraqiti disa nga propozim-rekomandimet, duke nënvizuar se këto propozim-rekomandime do të plotësohen dhe harmonizohen nga grupet parlamentare dhe në koordinim me deputetin Jeton Svirca, i cili do t'i prezantojë në Kuvend.

Kryetari, më pas hapi diskutimet lidhur me këtë pikë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Elmi Reçica - në emër të GP të PDK-së, Anton Quni - në emër të GP të LDK-së, Faton Topalli - në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Burim Ramadani - në emër të GP të AAK-së, si dhe Jeton Svirca, Sabri Hamiti, Myfera Shinik, Shaip Muja, Sadri Ferati, Teuta Haxhiu, Myzejene Selmani, Jakup Krasniqi, Lumnije Morina, Nazane Breca, Amir Ahmeti, Kymete Bajraktari, Xhevahire Izmaqi, Gëzim Kelmendi, Hydajet Hyseni, Alma Lama, Halit Krasniqi, Albin Kurti, Kymete Bytyçi, Haki Demolli, ministri Bajram Rexhepi dhe Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputetët Teuta Sahatqija, Xhafer Tahiri dhe Flora Brovina, diskutimet e parapara i dorëzuan me shkrim.

Deputeti Jeton Svirca, në emër të propozuesit të çështjes, në fund të debatit tha se do ta harmonizojmë tekstin e rekomandimeve me të gjitha grupet parlamentare dhe në vazhdimin e seancës për ditën e nesërme do t'ia paraqesim Kuvendit.

Në vazhdim kryetari konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për procedimin me votim.

Kryetari, në mungesë të kuorumit, i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 18:45 minuta për t'i vazhduar nesër në orën 10:00.

28 shkurt 2014, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 27 shkurt 2014

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 27 shkurt 2014.

Para se të procedojë me pikat e rendit të ditës, kryetari njoftoi Kuvendin se iniciuesit e debatit lidhur me gjendjen e sigurisë në shkollat e Republikës së Kosovë, kanë kërkuar që votimi i Propozim-rekomandimeve të bëhet në mbledhjen plenare të radhës.

Kuvendi u pajtua me propozimin e lartpërmendur.

Në vazhdim kryetari procedoi me pikat, si në vijim:

10. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë

Kryetari e ftoi deputeten Ganimete Musliu, që në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Ganimete Musliu tha se përmbajtja e legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara është e ndarë në tri fusha.

Ligjet specifike të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, ligjet të cilat përmbajnë dispozita që u përkasin personave me aftësi të kufizuara, udhëzime administrative dhe rregullore për personat me aftësi të kufizuara. Ligjet më të rëndësishme të dedikuara në mënyrë specifike për këtë kategori janë: Ligji për personat me aftësi të kufizuara nr. 2003/23; Ligji për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme; Ligji për aftësim, riaftësim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara; Ligji për personat e verbër. Ndërsa, ligjet që përmbajnë provizione relevante lidhur me personat me aftësi të kufizuara janë: Ligji për shëndetësi; Ligji i punës; Ligji mbi ndërtimin; Ligji për diskriminimet; Ligji për skemën e asistencës sociale; Ligji mbi arsimin parauniversitar dhe Ligji për sportin. Ka edhe disa akte tjera legjislative të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara, që janë:

-Udhëzimi administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasje personave me aftësi të kufizuara;

- Udhëzimi administrativ për procedurat e aplikimit për njohjen e të drejtave për aftësim, riaftësim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara.

Shërbimet shëndetësore, arsimore, shoqërore dhe ato të punësimit për personat me aftësi të kufizuara janë të pakta dhe të një cilësie të dobët, prandaj, institucionet do ta japin kontributin

që të krijojmë kushte, mundësi që këta persona të ndihen të barabartë dhe mos të ndihen të diskriminuar në shoqëri. Po ashtu, duhet të krijojmë kushte që personave me aftësi të kufizuara t'u jepet mundësia ta ushtrojnë kapacitetin e tyre dhe vërtet ta zhvillojnë potencialin dhe të zgjedhin mënyrën e jetesës së tyre.

Shpesh na rastis që personat me aftësi të kufizuara të paragjykoen dhe të stigmatizohen nga rrethi dhe shoqëria dhe kjo vjen në pah shpeshherë te fëmijët me sindromin 'Down'. Po ashtu, edhe pse nuk hyjnë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, kjo shpesh ndodh edhe te fëmijët me autizëm, të cilët bëjnë përpjekje për t'u adaptuar dhe integruar në shoqëri.

Këta fëmijë kanë nevojë për qendër profesionale për diagnostifikim, qendër profesionale për trajtimin e tyre, kushte për vijimin e shkollave të rregullta, investim në formimin e kuadrove profesionale për punë me këta fëmijë, informim të mirëfilltë të shoqërisë dhe rrethit ku ata jetojnë. Shqetësim tjetër është edhe largimi i personave të shurdhër nga skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara nga komisioni, me arsyetim se janë të aftë për punë e kur dihet se për shkak të barrierave të komunikimit personat e shurdhër janë personat më të diskriminuar në sferën e punësimit brenda aftësisë së kufizuar me vetë faktin se në institucionet publike asnjë person i shurdhër ende nuk është i punësuar.

Nuk mjafton që të kemi vetëm ligje të standardizuara në letër, por duhet ta plotësojmë standardin evropian në praktikë dhe këta njerëz të mos ndihen të diskriminuar dhe të marginalizuar, sepse fatmirësisht ka shumë prej tyre që janë të aftë që të kryejnë shumë punë bashkërisht me të gjithë personat tjerë të shoqërisë sonë.

Unë kam shkruar vetëm dy rekomandime që do t'ia rekomandoj seancës, por pres shumë që nga ju të zëbërthehen dhe të dalin sugjerime dhe rekomandime tjera, që të plotësohet edhe më tepër ky debat. Atëherë, unë kërkoj që të zbatohet strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2013-2023 në Republikën e Kosovës dhe të zbatohen ligjet në fuqi ose nëse këto ligje me të vërtet janë të pazbatueshme, atëherë të bëhet plotësim-ndryshimi i tyre.

Kryetari, më pas hapi diskutimet lidhur me këtë pikë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Suzan Novoberdaliu – në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjini, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, Flora Brovina - në emër të GP të PDK-së, Rita Hajzeraj- Beqaj - në emër të GP të LDK-së, Albana Gashi - në emër të GP të Lëvizjes "Vetëvendosje", Teuta Haxhiu - në emër të GP të AAK-së, si dhe Gëzim Kelmendi - në emër të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Jakup Krasniqi, Shaip Muja, Alma Lama, Faton Topalli, Kymete Bajraktari, Goran Marinković, Aurora Bakalli, , Halit Krasniqi, Flora Brovina, Kymete Bytyçi, Afrim Hoti, Nijazi Idrizi, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Donika Kadaj-Bujupi, Hydajet Hyseni, Sadri Ferati, Daut Haradinaj, Agim Kuleta, Hatim Baxhaku, Hamza Balje, Amir Ahmeti dhe ministri Nenad Rashiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputetja Ganimete Musliu, në emër të propozuesit të çështjes, në fund të debati paraqiti tekstin e Propozim-rekomandimeve dhe kërkoj që ato të votohen në mbledhjen plenare të radhës.

Kuvendi u pajtua me propozimin e deputetes Ganimete Musliu.

Kryetari, në mungesë të kuorumit për të proceduar me votim, procedoi me shqyrtimin e pikës tjetër të radhës.

11. Debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të IGK “Ballkani”, në Suharekë

Kryetari e ftoi deputetin Armend Zemaj, që në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Deputeti Armend Zemaj tha se fabrika IGK “Ballkan” nga Suhareka ishte një ndër fabrikat më renome ndërkombëtare si në aspektin e zhvillimit ekonomik, por edhe atë të punësimit.

Ky gjigant ekonomik u privatizua në maj të vitit 2005 në të ashtuquajturin spin off special, domethënë me vetëm një ofertues i cili ishte edhe në kundërshtim me Rregulloren e atëhershme të AKM-së për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore.

Me shitjen e këtij aseti ekonomik, punëtorët me shqetësim të drejtë iu drejtuan institucioneve vendore dhe ndërkombëtare duke e kundërshtuar këtë proces, por të cilin asnjëherë nuk morën përgjigje pozitive apo edhe të marrin atë që u takon.

Nga raporti i vlerësimit edhe të Auditorit të Jashtëm dëshmohet se blerësi i përkohshëm nuk i kishte plotësuar kushtet e kontratës në investime dhe punësim që nënkupton se ky blerës i ka paraqitur faturat e falsifikuara të fryra dhe me vlera dhjetëra herë më të mëdha.

Ky blerës i kontestuar jo vetëm që ka ulur cilësinë e prodhimit, por në vend që së paku të rrisë prodhimin ka filluar shitjen e tokës, ku vetëm një parcelë e ka shitur për 1.7 milionë euro dhe i tërë ky gjigant ekonomik është shitur për vetëm 1.4 milion euro. Gjithashtu sipas informatave që posedojmë i njëjti vazhdon edhe me oferta të tjera për shitjen e kësaj toke.

Grupi Parlamentar i LDK-së, vlerëson se nga të gjitha këto fakte ka dyshime që ky privatizim është përcjell me korrupsion, duke dëmtuar një aset të madh të Kosovës dhe të Suharekës, andaj kërkojmë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të formohet Komisioni Hetimor, i cili do të hetojë mënyrën e privatizimit, mospërmblidhjen e obligimeve nga ana e AKM-së dhe AKP-së, deri në tjetërsimin e pronës së fabrikës si dhe shitjen e kësaj prone personave të tretë.

Kryetari, më pas hapi diskutimet lidhur me këtë pikë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Shaip Muja - në emër të GP të PDK-së, Visar Ymeri - në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Burim Ramadani - në emër të GP të AAK-së, si dhe Fikrim Damka - në emër të GP “6+”, si dhe Ramë Vataj, Kymete Bytyçi, Albana Gashi, Aurora Bakalli, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Afrim Hoti, Xhevdet Neziraj, Ramiz Lladrovci, Xhafer Tahiri, Shaip Muja, Daut Haradinaj, Muhamet Mustafa, Zenun Pajaziti, Alma Lama, Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti, Ali Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Armend Zemaj, në emër të propozuesit të çështjes, në fund të debati paraqiti tekstin e Propozim-rekomandimeve për votim.

Kryesuesi, në mungesë të kuorumit për të proceduar me votim, procedoi me shqyrtimin e pikës tjetër të radhës.

12. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar

Kryesuesi i njoftoi deputetët me propozimet e Grupit Parlamentar të AAK-së, për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Ai kërkoi nga deputetët që, nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të AAK-së.

Kuvendi miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të AAK-së që deputeti Nijazi Idrizi, emërohet anëtar i Komisionit parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në vend të deputetit Daut Haradinaj.

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:40 minuta.

13 mars 2014, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 27 shkurt dhe e vazhduar më 28 shkurt 2014

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari procedoi me pikat e papërfunduara, si në vijim:

9. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë në shkollat e Republikës së Kosovë

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyrë për mbledhjen e sotme.

Deputetja Ganimete Musliu, ia paraqiti Kuvendit Propozim-rekomandimet e harmonizuara me grupet parlamentare lidhur me këtë debat parlamentar.

Kryetari më pas hodhi në votim Propozim-rekomandimet e paraqitura nga deputetja Ganimete Musliu lidhur me këtë debat.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 73,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 2.

Kryetari më pas konstatoi se Kuvendi nxori këto:

REKOMANDIME

1. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të kërkojë nga DKA-të të trajtojnë temën e sigurisë në të gjitha shkollat e Kosovës, nëpërmjet sensibilizimit të mësimitdhënësve dhe personelit tjetër për sigurinë në shkolla, faktorët që dëmtojnë sigurinë, metodat e reagimit në raste të tilla dhe masat që duhet të ndërmerren nga institucionet e shkollës.
2. Secila shkollë të ketë një plan operativ të diskutuar më parë me personelin e shkollës dhe të njohur për të gjitha strukturat e shkollës se si duhet të veprohet në rast kur ndodhin mosmarrëveshje ndërmjet nxënësve dhe zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve.
3. Shkollat t'i sigurojnë në fillim të vitit të ri shkollor të gjitha të dhënat e nevojshme që mundësojnë kontaktin me prindin.
4. Shkollat të aktivizojnë Këshillin e shkollës dhe të kujdesen për funksionimin e tij të rregullt.
5. Drejtoritë komunale të arsimit t'i raportojnë Ministrisë së Arsimit për masat që kanë ndërmarrë për sigurinë në shkolla, ndërsa, Ministria e Arsimit, i raporton Kuvendit një herë në 6 muaj.
6. Të kthehet ora e kujdestarisë në të gjitha shkollat.
7. Të kthehen pedagogët në të gjitha shkollat.

10. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyrë për mbledhjen e sotme.

Deputetja Ganimete Musliu ia paraqiti Kuvendit Propozim-rekomandimet e harmonizuara me grupet parlamentare lidhur me këtë debat parlamentar.

Kryetari më pas hodhi në votim propozim-rekomandimet e paraqitura nga deputetja Ganimete Musliu lidhur me këtë debat.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 76,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari më pas konstatoi se Kuvendi nxori këto:

REKOMANDIME

- 1 Komisionet përkatëse parlamentare të bëjnë monitorimin e ligjeve që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve të personave me aftësi të kufizuara dhe t'i raportojnë Kuvendit, në afat sa më të shkurtër, në mënyrë që Kuvendi t'i shqyrtojë dhe t'i fillojë procedurat e plotësimit ndryshimit për ligjet që kanë nevojë.
2. Ministritë përgjegjëse t'i zbatojnë ligjet në fuqi dhe t'i nxjerrin të gjitha aktet nënligjore nga të cilat përfitojnë personat me aftësi të kufizuara.
3. Të formohet një ekip koordinues ndërmjet ministrive të linjës që të bëjnë koordinimin e detyrave që dalin nga ligjet, në mënyrë që këto ligje të gjejnë zbatimin e duhur.
4. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të hartojë një program që në mënyrë të vazhdueshme të ketë kampanja sensibilizuese për këto kategori.
5. Të zbatohet programi kombëtar për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave.
6. Të bëhet regjistrimi i të gjithë personave me aftësi të kufizuar, ky regjistër të freskohet në vazhdimësi dhe të dihet numri i saktë i tyre.
7. Të themelohet Qendra e diagnostifikimit të hershëm dhe të saktë të aftësisë së kufizuar.
8. Të përmirësohen kushtet e banimit dhe jetesës për personat me aftësi të kufizuar që janë rezident në Institutin Special në Shtime dhe Qendrën integruese të shëndetit.
9. Të sigurohet asistenca sociale-pedagogjike në kopshte dhe shkolla fillore.
10. Të formohet një grup për adaptimin dhe përshtatjen e teksteve dhe materialeve sipas specifikave të personave me aftësi të kufizuar.
11. Të rishikohet dhe të plotësohet lista e barnave esenciale për personat me aftësi të kufizuar.
12. Të bëhet rritja e transparencës së Fondit për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore.
13. Të bëhet rishikimi i skemës së pensionit të personave me aftësi të kufizuar dhe të bëhet harmonizimi bazuar në nevojat ekonomike dhe sociale.

11. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të IGK "Ballkan", në Suharekë

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit, procedimi me votim është shtyrë për mbledhjen e sotme.

Deputeti Armend Zemaj, paraqiti para Kuvendit Propozim-rekomandimin lidhur me këtë debat parlamentar.

Kryetari, më pas hodhi në votim Propozim-rekomandimin e paraqitura nga deputeti Armend Zemaj lidhur me këtë debat.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 6.

Kryetari, më pas konstatoi se Kuvendi nxori këtë:

R E K O M A N D I M

Të formohet Komisioni Hetimor Parlamentar, i cili do ta hetojë mënyrën e privatizimit të IGK “Ballkan”, në Suharekë për mos përmbushjen e obligimeve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, tjetërsimin e pronës së Fabrikës, si dhe shitjen e kësaj prone personave të tretë.

* * *

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 10:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale